



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 222/2 Prot.

Tiranë, më 09/03/2022

Lënda: Kujtesë për kthim përgjigje tonës nr. 222/1 prot., datë 09.02.2022.

**Televizionit Vizion Plus
Emisioni "Spot Light"
Rruga Don Bosko, Nr.5**

**Z. Arben MEÇE
Opinionist
Rruga Don Bosko, Nr.5**

Tiranë

**Për dijeni: Z. Denis KOSTURI
Përfaqësues i Rrjetit të Organizatave R/E, Korçë
Rruga "Pandi Raidhi", Lagjia 4, Nr. 45,
Përfaqësues i Rrjetit të Organizatave R/E**

Korçë

Sikurse ju kemi vënë në dijeni nëpërmjet shkresës sonë nr. 222/1 prot., datë 09.02.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është duke shqyrtuar ankesën nr. 21, datë 01.02.2022, e Rrjetit të Organizatave R/E, Korçë, ku pretendohet diskriminim në formën e gjuhës së urrejtjes, për shkak të "racës", të pakicës kombëtare rome, nga ana e opinionistit Arben Meçe, në Emisionin "Spot LIGHT", të moderuar nga z. Alban Dudushi, në Televizionin Vizion Plus, si dhe nga ana e Televizionit Vizion Plus.

Sipas informacionit të dhënë në ankesë nga pala ankuese, si dhe nga verifikimi i drejtpërdrejtë që KMD kreu në linkun <https://www.youtube.com/watch?v=25KWclSRia8>, rezulton se në datën 21.01.2022, në Emisionin "Spot LIGHT", të moderuar nga z. Alban Dudushi, në Televizionin Vizion Plus, gjatë diskutimeve të zhvilluara në studio, në minutën 75 opinionisti Arben Meçe ka përdorur shprehjen "si arrixinjtë në rrugë me trastën në kurriz" duke iu referuar grupimit të veçantë të një subjekti të caktuar politik. Subjekti ankues pretendon se shprehja e përdorur nga opinionisti Meçe është mbështetur nga kolegët pjesëmarrës në diskutim, sikurse dhe nga redaksia

e emisionit, e cila nuk ka reaguar, por përkundrazi e ka mbështetur duke i vënë titullin “*Spotlight - Shpërthen Meçe: Grupi i Berishës, si arrixhinjtë në rrugë! - 21 Janar 2022 - Vizion Plus*”, lajmit të hedhur në faqen www.youtube.com.

Rrjeti i Organizatave R/E në qytetin e Korçës shprehin indinjatën e thellë për këtë shprehje të përdorur nga opinionisti Arben Meçe, pasi dëmton imazhin e komunitetit rom dhe e diskriminon hapur këtë pakicë kombëtare. Subjekti ankues pretendon se opinionisti ka përdorur gjuhë urrejtje ndaj kësaj pakice kombëtare dhe kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit, në formën e gjuhës së urrejtjes, për shkak të racës, të komunitetit rom.

Komisioni ka kërkuar prapësimet përkatëse nga Televizioni Vizion Plus dhe z. Arben Meçe, mbi ankesën në fjalë, nëpërmjet shkresës nr. 222/1 prot., datë 09.02.2022. Për sa më sipër, rezulton se Televizioni Vizion Plus nuk i ka kthyer shkresës së sipërcituar së Komisionerit dhe ka kthyer mbrapsht zarfin me shkresën e opinionistit Arben Meçe, e cila ishte dërguar gjithashtu në adresën e këtij televizioni. KMD vë theksin në faktin se opinionisti Arben Meçe është ftuar, ka marrë pjesë dhe është shprehur në një emision të Televizionit Vizion Plus dhe ky i fundit, në cilësinë e subjektit kundër së cilit drejtohet ankesa, në bazë të nenit 33, pika 7, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ka detyrim ligjor për dhënien e prapësimeve të tij në lidhje me këtë ankesë, detyrim, i cili ekziston edhe për z. Meçe. KMD vë në dukje faktin se në datën 24.02.2022, i është drejtuar nëpërmjet e-mailit zyrtar Televizionit Vizion Plus, për të dërguar kontaktet e opinionistit, por nuk është dërguar asnjë përgjigje. Në rast pamundësie për dorëzim të shkresës tek opinionisti, KMD kërkon nga TV Vizion Plus, që të dërgohet zyrtarisht një numër kontakti dhe adresa elektronike e z. Arben Meçe, me qëllim që ai të dërgojë prapësimet e tij mbi ankesën e depozituar kundër tij nga Rrjeti i Organizatave R/E.

Për sa më sipër, KMD i bën kujtesë Televizionit Vizion Plus dhe z. Arben Meçe, për kthim përgjigje shkresës nr. 222/1 prot., datë 09.02.2022, brenda datës **09.03.2022**.

Duke shpresuar në bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI
Robert GAJDA
KOMISIONI I PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
TIRANË

